

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës , nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë , Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë publikon këtë :

K O N K U R S

Pozita : Punëtor i Mirëmbajtjes dhe Riparimeve NjO Istog

Ekzekutues : 1 (Një)

Kohëzgjatja e Kontratës: Kontrata lidhet për kohë të caktuar (6 mujore), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarëve .

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Te zbatoje me korrektësi dhe përgjegjësi disiplinën në punë dhe zbatimin e detyrave të ngarkuara;
- Të mbajë vendin e punës të pastër dhe të rregullt .
- Te bëjë gërmime dhe rimbushje me krahë, kur nevojitet;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikqyrësi;
- Te mos kundërshtojë dhe zbatojë , brenda kriterëve të caktuara, të gjitha detyrat që mund të ngarkohen nga Përgjegjësi i Sektorit , brenda profesionit të tij, duke raportuar për realizimin e tyre para eporit që i ngarkon këtë detyrë konkrete.

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

- Diploma e shkollës së mesme;
- Të ketë përvojë pune në kohëzgjatje prej 1 viti, në punë të ngjajshme;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatën që kandidati nuk është nën hetime;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Aftësi të mjaftueshme që herë pas here të merret me disa çështje të cilat nuk janë paraparë me udhëzime, por që lidhen me nevojat e kompanisë;

Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Rr” Lekë Dukagjini” Nr.156 Pejë dhe Web – faqen “ Hidrodrini” Sh. A. www.hidrodrini.com . Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr.“ Lekë Dukagjini“ nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës).

Shpallja do të jetë e hapur 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditore dhe Web – faqen www.hidrodrini.com

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionet e derguara pas afatit të caktuar më lartë nuk do të pranohen .Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen .

KRU “ Hidrodrini” Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.